

Në bazë të nenit 1, paragrafi 2 dhe nenit 16 të Ligjit për tatimin në patundshmëri (“Fl. zyr. RMZ”, nr. 65/01, 69/03 dhe “Fl. zyr. MZ”, nr. 75/10), nenit 51 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fl. zyr. RMZ”, nr. 23/95) dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fl. zyr. RMZ, – dispozitat e komunës nr.4/96) si dhe nenit 24, paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit për kundërvajtjet (“Fl. zyr. MZ”, nr. 1/11, 6/11, 39/11 dhe 32/14), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur, më __. __. 2015 ka nxjerrë

Vendimin për ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit për tatimin në patundshmëri

Neni 1

Neni 14 i Vendimit për tatimin në patundshmëri (“Fl. zyr. MZ”, – dispozitat e komunës nr.4/13) fshihet, kështu që neni tjetër 15 bëhet neni 14 etj.

Neni 2

Pas nenit 15 shtohet kapitulli i ri: “DISPOZITAT NDËSHKUESE” dhe neni 15 a është: “Me gjobë në të holla prej njëqind e pesëdhjetë deri në pesëmijë Euro (150 – 5000) do të gjobitet për shkelje personi nëse:

1. Nuk ia paraqet deklaratën tatimor Sekretariatit për financa dhe buxhet të Komunës së Ulqinit në afatin e paraparë.
2. Nuk e paguan obligimin tatimor në afatin e paraparë.
3. E paraqet deklaratën tatimor jo të plotë dhe të pasaktë.

Neni 3

Pas nenit 15a shtohet neni i ri 15b që është: “Me gjobë në të holla prej njëqind e pesëdhjetë deri në pesëmijë Euro (150 – 5000) do të gjobitet për shkelje personi fizik dhe personi përgjegjës në personin juridik nëse:

1. Nuk ia paraqet deklaratën tatimor Sekretariatit për financa dhe buxhet të Komunës së Ulqinit në afatin e paraparë.
2. Nuk e paguan obligimin tatimor në afatin e paraparë.
3. E paraqet njoftimin tatimor jo të plotë dhe të pasaktë.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës”

Numër: _____

Ulqin, më __. __. 2015

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Kryetari

Mr. Fuad Haxhibeti

Arsyetim

Mbështetja juridike për nxjerrjen e këtij Vendimi është në nenin 1, paragrafi 2 i Ligjit për tatimin në patundshmëri me të cilin është caktuar kompetenca e vetëqeverisjes lokale për futjen e tatimit në patundshmëri. Me nenin 24, paragrafin 4 të Ligjit për kundërvajtjet me të cilin është parashikuar e drejta e vetëqeverisjes lokale për caktimin e gjobave për shkelje si dhe me nenin 43, përkatësisht nenin 51 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale me të cilët janë definuar aktet të cilët i nxjerr Kuvendi i Komunës.

Shkaqet për nxjerrjen e këtij Vendimi në radhë të parë janë për futjen e masave ndëshkuese për mosrespektimin e dispozitave të Vendimit.

Me Vendimin për ndryshimet është fshirë neni 14 pasi që procedimi i organeve të vetëqeverisjes lokale nënkuptohet në bazë të dispozitave pozitive, kështu që numërimi i dispozitave procedurale ka qenë i panevojshëm dhe i pazakonshëm.

Me nenin 15 janë caktuar dispozitat ndëshkuese për shkelësit e dispozitave të këtij Vendimi.

Për realizimin e këtij Vendimi nuk janë të domosdoshme mjete të posaçme, kështu që ky Vendim me caktimin e dispozitave ndëshkuese do të përmirësojë efikasitetin dhe disiplinën fiskale.

SEKRETARIATI PËR FINANCA DHE BUXHET